



## TË DHËNAT PËR ASETIN

### Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.67

### Njësia e Vendosur në Tender Nr.15


### Apiko-Lokali (ish-depo) në Prishtinë

<b>Emri i NSh.-së</b>	Apiko, Deçan, në likuidim ("Ndërmarrja")
<b>Lloji i shitjes</b>	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur.
<b>Dita e Ofertimit</b>	Më 31.07.2024 nga ora 10:00h deri 12:00h, në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë.
<b>Regjistrimi i Ofertuesit</b>	Nuk ka parakualifikim
<b>Depozita e Ofertës</b>	25,000 Euro
<b>Vendndodhja e asetit</b>	Rruga UÇK nr. 90 (kompleksi banesorë Qafa), komuna Prishtinë
<b><u>Përshkrimi i asetit</u></b>	Lokal etazh (sh-depo) me sipërfaqe 238m <sup>2</sup> sipas matjeve në terren që ndodhet në katin përdhësë të një objekti banesorë në rr. UÇK nr. 90, në Prishtinë. Lokali është në gjendje të mirë dhe ka dy dalje.
<b>Ndërtesat dhe tokat</b>	<p>Toka nuk përfshihet në shitje.</p> <p>Pjesa e daljes nga ana e parkingut, në sipërfaqe 14m<sup>2</sup>, nuk është e përfshirë në sipërfaqen e llogaritur të lokalit, pasi që është shfrytëzuar si korridor i përbashkët nga Ndërmarrja dhe KEK, meqenëse aty janë të instaluar disa pajisje elektrike. Sipas një deklaratë të ish-Menaxhmentit të Ndërmarrjes dhe KEK, pronësia e kësaj pjese nuk është e përcaktuar pasi mungon dokumentacioni, por që është përdor në vijimësi nga të dy palët pa pengesë. KEK ka kërkuar dokumentacion në Ndërmarrjen Publike Banesore në Prishtinë e cila ka njoftuar se sipërfaqja 14m<sup>2</sup> është hapësirë ndihmëse e trafo stacionit elektrik pa ndonjë evidencë, kurse Arkivi i Komunës Prishtinë ka njoftuar se dokumente nuk gjenden në regjistrin e tyre.</p> <p>Për këtë lokal ka një kërkesë për negociim direkt.</p> <p>Shënim: Sipas kontratës së shitëblerjes, lokali kishte 365.78m<sup>2</sup>, nga e cila 100m<sup>2</sup> janë shitur nga Ndërmarrja në 1991 (vendim gjykatës nr. 464/95 i 1995).</p>
<b>Shfrytëzuesit</b>	Lokali përdoret nga palë e tretë me qira valide deri me 12/11/2024.
<b>Asetet tjera</b>	Nuk ka asete të tjera të përfshira në këtë shitje, përveç kësaj të përshkruar me lartë
<b>Detyrimet që do të barten</b>	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.



Foto/fotot  
Ose informata të tjera  
Për asetet në shitje

### NSH APIKO - DEPO NË PRISHTINË (TE QAFJA)



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

AKP - ZR Pëjë

#### Legjendë

- NSH Apiko- Depo në Prishtinë me sip. 238m<sup>2</sup>
- Ndërtesa
- Tuneli i ndërtesës



Informatat rreth Njësisë lëndë e shitjes të prezentuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>.



## Raporti i vizitës në terren



Me datë 21.06.2024 zyrtarët e AKP ZR Pejë vizituan pronën e NSH Apiko, Depo në Prishtinë e cila ndodhet në rrugën "UÇK" Qafa 1- Prishtinë.



Ortofoto- NSH Apiko, Depo në Prishtinë

Depo ndodhet në katin përdheshë të ndërtesës shumëkatëshe. Numri i ndërtesës i regjistruar në kadastrin e ndërtesave KN është: O-71914059-10046-0-278-0 me sipërfaqe prej 5=829 m<sup>2</sup> në posedim/ bashkëpronësi në ndërtesë në pjesë të përbashkëta për njësi të veçanta.

Ndërtesa shtrihet në kuadër të parcelës kadastrale me numër të njësisë 10046-0 pronë e cila evidentohet në emër të P.Sh Pronë Komunale.

Në bazë të matjeve të realizuara më shirit metër, sipërfaqja e përafërt e shfrytëzueshme neto e depos është 238m<sup>2</sup>.



Lokali i ka dy hyrje, hyrja kryesore nga rruga e UÇK-së është shënuar në skicë si Hyrja 2 dhe hyrja tjetër nga parkingu – hyrja 1.



Duhet cekur se hyrja nga parkingu ( Hyrja 1 ) realizohet përmes korridorit të përbashkët me KEDS-in. Korridorit i përbashkët me sip.14m<sup>2</sup> është paraqitur në skicën e matjes mirëpo nuk është përfshirë në sipërfaqen e përgjithshme prej 238m<sup>2</sup>.

Fotografitë e mëposhtme prezantojnë gjendjen faktike të NSH Apiko – Depo në Prishtinë:





Hasibe Krasniqi- Zyrtare e Operacioneve për Administrin të Aseteve

*Hasibe Krasniqi*


Blerita Jashari Kastrati- Zyrtare Kadastrale Rajonale  
Dren Gojani-Zyrtar Kadastral Rajonal

*Blerita Jashari Kastrati*

AKP-ZR PEIË/Qershor 2024



## NSH Apiko Depo në Prishtinë Skica e matjes



### Legjendë

	Hyrja- Korridori i përbashkët me Kek-un me sip. 14 m <sup>2</sup>	=238m <sup>2</sup>
	Pjesa kryesore e lokalit me sipërfaqe neto prej 205.6m <sup>2</sup>	
	Korridori nr.2 , magazina, toaletet - me sipërfaqe neto prej 31.84m <sup>2</sup>	

### Informatat

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400 ext.1090,2059

Fax: +383 (0) 38 248 076

[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

### Dokumentet e Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rruga: Dritan Hoxha, nr.55

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës